



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 110 Prot.

Tiranë, më 05.01.2024

SJELLJE NË VËMENDJE

Drejtuar: Autoriteteve/enteve kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), në kuadër të ushtrimit të detyrave të saj në bazë të nenit 23, gërma "ç" të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në funksion të mbarëvajtjes së Sistemit të Prokurimit Publik, sjell në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore, si më poshtë vijon:

Në hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, autoritetet/entet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht parashikimet e nenit 3, pikat 3 dhe 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilat përcaktohet se:

"3. Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës.

4. Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i zërave të tij nga APP-ja duhet të bëhet brenda 3 (tre) ditëve nga dita e nesërme e punës, nga dërgimi i tij për publikim në sistem".

Sa më sipër, me anë të këtij njoftimi, sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore që, të respektojnë dispozitat e mësipërme ligjore, për krijimin e zërave/elementëve të regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit, me qëllim mirëplanifikimin dhe zhvillimin në kohë të procedurave të prokurimit.

Duke ju falënderuar,

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Reida Kasha

